



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:100349

Datë: 18.03.2025

Numri i dokumentit: 07006081

C.nr.1552/2024

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.N. nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Leutrim Ademi, avokat në komunën e Mitrovicës, kundër të paditurës QRK - MM - FSK , me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti pagesën e kompensimit për ngritje ne pagë sipas rregullores së(QRK), nr.02/2020, jashtë seance gjyqësore, më datë 18.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A.N. nga Komuna e Mitrovicës, kundër të paditurës QRK - MM - FSK , me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të diferencës në pagë për ngritje profesionale, për periudhën kohore 01.02.2020 - 28.07.2021, duke llogaritur diferencën nga 259.17€ në muaj, e në total shumën prej 4,665.06 € me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë deri në pagesën definitive, e pa bazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 13.08.2024, ka paraqitur padi, të precizuar me dt. 02.09.2024 në këtë gjykatë, kundër të paditurës, me objekt të kontestit kompensimin për ngritje në pagë, me vlerë të kontestit 4,665.06€, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë deri në pagesën definitive, si dhe t'i kompensoi shpenzimet e procedurës.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitën CS-3Tetar ose Specialist. Ka shtuar se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.09/117 të datës 22.01.2020 është aprovuar Rregullorja Nr.02/2020 për Pagat, Shtesat mbi Pagë dhe Kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën së Sigurisë së Kosovës. Bazuar në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 të kësaj Rregullore, ndërlidhur me shtojcën nr.1, ka theksuar se është përcaktuar që paga bazë sipas gradës së paditësit duhet të paguhet në shumën prej 641.32 euro, ndërsa paditësi për periudhën si në kërkesëpadi për këtë gradë është paguar në shumë prej 382.15 euro. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyrojë të paditurën që në emër të kompensimit ngritjes profesionale me gradën (CS-3Tetar ose Specialist), për periudhën 01.02.2020 deri me dt. 28.07.2021, për 18 muaj t’ia paguaj diferencën në shumën prej 4,665.06€, si dhe kamatë ligjore në shumë prej 8% nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë në emër te përpilimit te padisë shumen prej 104 euro, si dhe në emër në taksës gjyqësore shumën prej 21 euro.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejtë se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkangjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr.1552/2024, të datës 17.01.2025, e detyron të paditurën që në afatin prej 15 ditësh të paraqesë përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se shërbimi në FSK është i rregulluar dhe përcaktuar me ligj të veçantë, ku janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve të FSK-së, e nga ky ligj është përcaktuar se pagat, shtesat mbi pagë dhe llojet e tjera të kompensimit përcaktohen me akt veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, ashtu që më datë 14.02.2020 është publikuar në Gazetën Zyrtare edhe rregullorja nr.02/2020 që përcakton këto kompensime, e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në mungesë të mjeteve buxhetore, që nga momenti i miratimit të rregullores, e njëjta nuk ka gjetur zbatim, prandaj me vendimin nr.10/21 të dt.28.07.2021 të Qeverisë së Kosovës është pezulluar shtojca e rregullores me të cilën janë përcaktuar pagat sipas gradave ushtarake dhe ekuivalenca e personelit. Ka konsideruar se kërkesa e paditëses është e parashkruar bazuar në dispozitat e nenit 341 dhe 342 të LMD-së dhe nenit 87 të LP-së, pasi që nga hyrja në fuqi e rregullores e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite. Lartësinë e kërkesëpadisë

nuk e ka kontestuar. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: kontrata e punës e datës 18.05.2021, si dhe transaksionet bankare për periudhën kohore 01.01.2019 deri 31.12.2021.

Meqenëse paditësi Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyrojë të paditurën që në emër të kompensimit ngritjes profesionale me gradën (CS-3Tetar ose Specialist), për periudhën 01.02.2020 deri me dt. 28.07.2021, për 18 muaj t'ia paguaj diferencën në shumën prej 4,665.06€, gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura në kuptim të nenit 399 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seance ashtu që me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Gjykata për vendosje në këtë çështje kontestimore ka zbatuar dispozitat ligjore nga Ligji i Punës në të cilin parashihet se parashihet që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.*

Gjykata, vlerëson se kërkesa e paditësit është e parashkruar në tërësi, për shkak se paditësi ka paraqitur padinë me datën 13.08.2024 dhe komform nenit 87 të Ligjit të Punës, parashihet që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”* Andaj, kërkesa e paditësit, kërkesë kjo e cila ka të bëjë me periudhën kohore prej datës 01.02.2020 e deri me 28.07.2021 është parashkruar në tërësi dhe atë në lartësi prej 4,3665.06€.

Në lidhje më afatin e për Ankesë prej 7 ditësh, Gjykata vendosi në bazë të nenit 476 dhe 477 të LPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 450, lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK, ashtu që pala paditëse nuk e ka fituar kontestin, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, ashtu që gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartëcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1552/2024, më datë 18.03.2025

Gj y q t a r i
Skender Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.